



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

MBI
LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË VLERËSUESIT TË DËMEVE
NË SIGURIME

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 85, datë 03.07.2017
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 36, datë 27.03.2019
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 164, datë 14.08.2019
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 25, datë 28.02.2022
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 119, datë 25.07.2025

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i rregullores është përcaktimi i:

1. Kërkesave, procedurave, afateve për licencimin dhe rinovimin e licencës së vlerësuesve të dëmeve në sigurime, si person fizik;
2. Rasteve dhe procedurave të refuzimit, revokimit dhe pezullimit të licencës së vlerësuesit të dëmeve si person fizik;
3. Kërkesave, procedurave, afateve për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, si person juridik;
4. Rastet dhe procedurat e refuzimit, revokimit dhe pezullimit të licencës së vlerësuesit të dëmeve si person juridik;
5. Shfuqizohet;
6. Afateve dhe përmbajtjes së raportimit që duhet të përgatisë dhe të depozitohet në Autoritet, vlerësuesi i pavarur i dëmeve në sigurime.

Neni 2

Baza ligjore

Baza ligjore e rregullores është neni 14, pika 2 e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neni 131, pika 5, neni 227, pika 2, 3, 4, 5 e Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, në vijim shkurt do të përmendet Ligji 52/2014.

KREU II

PROCEDURAT DHE AFATET PËR LICENCËN E VLERËSUESIT TË DËMEVE SI PERSON FIZIK

Neni 3

Paraqitja e dokumentacionit për licencim

1. Personi fizik që kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime, paraqet pranë Autoritetit një kërkesë me shkrim, sipas formë kërkesës tip, që i bashkëlidhet dhe është pjesë e kësaj rregulloreje, të shoqëruar me:
 - a. CV dhe kopje të dokumentit të identifikimit;
 - b. Kopje e noterizuar e diplomës universitare;
 - c. Dokument/certifikatë, i cili vërteton që ka kryer një kualifikim profesional për vlerësues dëmsh, të lëshuar nga një institucion apo organizatë e njohur profesionale;
 - d. Dokument që vërteton eksperiencën 3-vjeçare në vlerësim dëmi, i cili në rastin e eksperiencës pranë:
 - i. Një vlerësuesi të licencuar, të punësuar në një shoqëri sigurimi, mund të jetë libreza e punës ose vërtetimi i lëshuar nga administratori i shoqërisë, i shoqëruar me informacion mbi pagën dhe sigurimet shoqërore, si dhe vlerësimin e vlerësuesit të licencuar, pranë të cilit ka fituar eksperiencën aplikanti për licencë;
 - ii. Një vlerësuesi të licencuar të pavarur është vërtetimi i lëshuar nga vlerësuesi për afatin e eksperiencës, përvojën e përfituar dhe vlerësimin mbi këtë përvojë, me kushtin që vlerësuesi i pavarur të ketë njoftuar Autoritetin mbi prezencën e personit që në momentin e fillimit të praktikës/punës.
 - e. Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
 - f. Deklaratë personale që nuk është dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes;
 - g. Dokument që vërteton se nuk ka detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore dhe vërtetim nga Regjistri i Kredive pranë Bankës së Shqipërisë, për gjendjen e kredive në sistemin bankar;
 - h. Deklaratë personale se kërkuesi për licencë, si dhe bashkëshorti/bashkëjetuesi, prindërit dhe

fëmijët madhorë, përfshirë dhe ato në kujdestari, nuk janë aksionarë të shoqërisë së sigurimit, agjentë dhe brokera në sigurime, apo persona që merren me administrimin dhe auditimin e shoqërisë së sigurimit;

- i. Deklaratë personale që nuk është i angazhuar në veprimtari tjetër biznesi apo profesion që cenon integritetin, pavarësinë dhe aftësitë profesionale të tij;
- j. Deklaratë personale që, në vlerësimin e dëmeve do të veprojë në përputhje me standardet dhe etikën profesionale dhe do të respektojë aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Dokumentacioni i parashikuar në shkronjën “d”, dokument që vërteton eksperiencën 3-vjeçare në vlerësim dëmi, nuk kërkohet në rastin kur kandidati e ka paraqitur kërkesën pas 6 muajve nga mbarimi i afatit të licencës së vlerësuesit të dëmeve, meqenëse sipas nenit 7, pika 2 të kësaj rregulloreje, kërkesa konsiderohet si kërkesë për licencë të re.

2. Dokumentacioni i kërkuar për licencim duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopje e noterizuar, lëshuar jo më herët së 3 muaj nga data e paraqitjes në Autoritet.
3. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 4

Shqyrtimi i kërkesës për licencim dhe afatet e licencimit

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur për licencim, për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti nëse vëren mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, apo nëse e gijkon të nevojshme, njofton kërkuuesin për miratim/licencim për plotësimin e tyre brenda një afati 30 ditor. Ky afat mund të zgjatet edhe me 30 ditë të tjera për arsye të justifikuara. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk plotësohet dokumentacioni, shqyrtimi i kërkesës/aplikimit ndërpritet. Në rast riaplikimi, dokumentacioni duhet të depozitohet nga e para.
- 2/1. Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të personit juridik, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.
3. Autoriteti, pas plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuarit për licencë, si dhe kalimit të testimit, brenda 2 muajve jep licencën për ushtrim veprimtarie në vlerësimin e dëmeve.
4. Vendimi i Autoritetit bëhet i ditur më shkrim aplikantit, brenda 10 ditëve nga data e marrjes

së tij.

5. Pajisja me licencë për ushtrim veprimtarie vlerësim dëmsh në sigurime shoqërohet me pagesën e tarifës për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 5 Licenca

1. Licenca e vlerësuesit të dëmeve në sigurime është profesionale, individuale dhe e patjetërsueshme.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve është e përcaktuar sipas klasave dhe llojeve të dëmeve.
3. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime është e vlefshme për një afat 5-vjeçar.
4. Licenca përgatitet në dy kopje, në gjuhën shqipe. Një kopje i jepet të licencuarit dhe një kopje arkivohet në AMF.

Neni 6 Refuzimi i licencës

Personit fizik, i cili kërkon të pajiset me licencë për vlerësues dëmi, i refuzohet licenca nëse:

- a. Dokumentacioni i paraqitur sipas nenit 3, të kësaj rregullore nuk plotëson kërkesat e nenit 227, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- b. Nuk kalon testimin për njohuritë sipas kërkesave të rregullores respektive;
- c. Në 3 vitet e fundit para datës së paraqitjes së kërkesës, është dënuar administrativisht për shkelje që lidhen me veprimtarinë në fushën e sigurimeve;
- d. Ka bërë vlerësime dëmi pas përfundimit të afatit të licencës.

Ky shkak për refuzimin e licencës është vetëm për ato raste kur kërkuesi e ka depozituar kërkesën pas 6 muajve nga përfundimi i afatit të licencës paraardhëse dhe për këtë arsye kërkesa konsiderohet si kërkesë për licencë të re.

Neni 7

Rinovimi i licencës

1. Kërkesa për rinovim duhet të shoqërohet me:
 - a. CV dhe kopje të dokumentit të identifikimit;
 - b. Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
 - c. Deklaratë personale se kërkuesi, si dhe bashkëshorti/bashkëjetuesi, prindërit dhe fëmijët madhorë, përfshirë dhe ato në kujdestari, nuk janë aksionarë të shoqërisë së sigurimit, agjentë dhe brokera në sigurime, apo persona që merren me administrimin dhe auditimin e shoqërisë së sigurimit;
 - d. Deklaratë personale se nuk është dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes;
 - e. Deklaratë personale që nuk është i angazhuar në veprimtari tjetër biznesi apo profesion që cenon integritetin, pavarësinë dhe aftësitë profesionale të tij;
 - f. Dokument që vërteton se nuk ka detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore dhe Vërtetim nga Regjistri i Kredive pranë Bankës së Shqipërisë, për gjendjen e kredive ne sistemin bankar;
 - g. Dokumenti/certifikata që vërteton se ka kryer një trajnim profesional për vlerësues dëmsh në periudhën ndërmjet licencimit të mëparshëm dhe kërkesës për rinovim, sipas të dhënave të regjistrit të Autoritetit;
 - h. Kalimin me sukses të testimit të organizuar nga Autoriteti, për përditësimin e njohurive profesionale dhe legjislacionit në fushën e sigurimeve.

2. Si rregull kërkesa për rinovim licence depozitohet në Autoritet 6 muaj para përfundimit të afatit. Përgjithësisht, edhe për rastet kur kërkesa depozitohet në Autoritet deri në 6 muaj nga mbarimi i afatit të licencës paraardhëse, kërkesa do të konsiderohet si kërkesë për rinovim licence. Ndërsa, kur kërkesa depozitohet pas 6 muajve nga përfundimi i afatit të licencës paraardhëse, atëherë kërkesa do të konsiderohet si kërkesë për licencë të re.

3. Autoriteti kur plotësohen kërkesat e mësipërme rinovon licencën brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës.

Neni 8

Rastet dhe procedura e refuzimit të rinovimit të licencës

1. Kërkesa për rinovim të licencës refuzohet kur:
 - a. Nuk përmbushen kërkesat për rinovim licence, sipas nenit 7, të kësaj rregulloreje;
 - b. Në vitin e fundit para datës së paraqitjes së kërkesës, është dënuar me gjobë për shkelje që lidhen me veprimtarinë e tij si vlerësues dëmsh;
 - c. Ka bërë vlerësime dëmi pas përfundimit të afatit të licencës.

2. Procedura e refuzimit të rinovimit të licencës bazohet në Kodin e Procedurave Administrative. Njoftimi i mosrinovimit të licencës bëhet me shkrim. Vendimi përfundimtar njoftohet me shkrim. Personi ka të drejtë për t`u dëgjuar dhe kur njoftimi i vendimit bëhet me takim, Autoriteti mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer.

Neni 9

Rastet dhe procedura e revokimit të licencës

1. Autoriteti i revokon licencën personit fizik si vlerësues i dëmeve, në rastet kur:
 - a. Ka shkelur kushtet e licencimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe të kësaj rregulloreje;
 - b. Licenca është marrë mbi bazën e të dhënave jo të vërteta, të rreme, dokumente të falsifikuara;
 - c. Nuk disponon policën e përgjegjësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 229 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - d. Nuk përmbush më kushtet, për të cilat i është dhënë licenca;
 - e. Nuk respektohen kufizimet e përcaktuara në nenin 230 pika 1, 2, 3, 4, 5;
 - f. Dënohet me vendim të formës së prerë për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare, veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet dhe vepra penale të tjera;
 - g. Nuk fillon veprimtarinë si vlerësues dëmsh brenda gjashtë (6) muajve nga data e marrjes së licencës;
 - h. Heq dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë si vlerësues dëmsh.
2. Autoriteti i revokon licencën personit fizik si vlerësues i dëmeve:
 - a. Në rastet e parashikuara në nenin 228, pika 1 të Ligjit 52/2014.
 - b. Kur provohet se vazhdon situata e shkeljes së ligjit edhe pas dhënien së gjobës, për:
 - i. Ushtrim të veprimtarisë në kundërshtim me parimet e paanshmërisë të përcaktuara në nenin 233, të Ligjit 52/2014;
 - ii. Ushtrim të veprimtarisë në kundërshtim me standardet dhe etikën profesionale të përcaktuara në nenin 234, të Ligjit 52/2014;
 - iii. Mosrespektim të kufizimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 230, të Ligjit 52/2014.
3. Procedura e revokimit të licencës bazohet në Kodin e Procedurave Administrative. Njoftimi i fillimit të procesit të revokimit të licencës, bëhet me shkrim dhe vendimi përfundimtar njoftohet me shkrim. E drejta për t`u dëgjuar realizohet në takimin në Autoritet dhe kur njoftimi i vendimit bëhet me takim, Autoriteti mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer.

Neni 10

Rastet dhe procedura e pezullimit të licencës

1. Pezullimi i licencës së vlerësuesit të dëmeve si person fizik, për një afat maksimumi deri në tridhjetë (30) ditë, bëhet për rastet kur:
 - a. Nuk ka depozituar kopjen e Ekstraktit të regjistrimit të tij në QKB, brenda dhjetë (10) ditëve nga dhënia e licencës (për vlerësuesin e pavarur);
 - b. Kanë kaluar dhjetë (10) ditë nga përfundimi i vlefshmërisë së policës për sigurimin e përgjegjësisë profesionale dhe nuk është rinovuar polica e sigurimit.
2. Pezullimi i licencës së vlerësuesit të dëmeve si person fizik, bëhet me vendim të Autoriteti kur për shkelje të lehtë të ligjit i janë caktuar masa dhe afat për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive. Afati i pezullimit është maksimumi deri në 6 muaj.
3. Procedura e pezullimit të licencës bazohet në kodin e procedurave administrative.

Njoftimi i fillimit të procesit të pezullimit të licencës, bëhet me shkrim. Vendimi përfundimtar njoftohet me shkrim. Personi ka të drejtë për t'u dëgjuar dhe kur njoftimi i 7 vendimit bëhet me takim, Autoriteti mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer.

Neni 10/1

Testimi i njohurive

Testimi për njohuritë profesionale organizohet nga Autoriteti, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktin e posaçëm për këtë qëllim.

Neni 11

Shfuqizohet.

Neni 12

Shfuqizohet.

Neni 13

Shfuqizohet.

KREU IV
KËRKESAT, PROCEDURAT DHE AFATET PËR VLERËSUESIN E DËMEVE SI
PERSON JURIDIK

Neni 14

Kërkesat e licencimit të personit juridik

1. Personi juridik si vlerësues dëmsh organizohet si shoqëri aksionare ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt të vetëm veprimtarinë e vlerësimit të dëmeve në sigurime, sipas dispozitave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
2. Shoqëria që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e vlerësimit të dëmeve në sigurime paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentacionin përkatës, që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave të mëposhtme:
 - a. Të jetë i regjistruar në QKB si shoqëri aksionare ose si sh.p.k;
 - b. Të ketë të paktën një vlerësues të licencuar të punësuar;
 - c. Administratori/ët dhe anëtari i Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të administrimit të shoqërisë duhet:
 - i. Të ketë diplomë universitare;
 - ii. Të ketë përvojë profesionale në një nga fushat që lidhet me sigurimet, jurisprudencën, ekonominë, statistikën, inxhinierinë, shkencat e natyrës;
 - iii. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë gjatë 5 viteve të fundit për ndonjë vepër penale;
 - iv. Të mos jetë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamartjes;
 - v. Të mos ketë detyrime fiskale të papaguara në afat.
 - d. Aksionari/ët ose ortaku/ët i shoqërisë të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe të mos ketë detyrime të papaguara në afat;
 - e. Të ketë paguar tarifën për depozitimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për llogari të AMF-së;
 - f. Shoqërisë nuk i është revokuar më parë licenca sipas parashikimeve të nenit 18, të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Dokumentacioni për licencimin e personit juridik si vlerësues dëmsh

1. Shoqëria që aplikon për pajisjen me licencë vlerësuesi dëmsh në sigurime depoziton në

Autoritet:

- a. Kopjen e Ekstraktit të regjistrimit të saj në QKB si shoqëri aksionare ose sh.p.k;
 - b. Kopjen e Statutit;
 - c. Kontratën e punësimit me vlerësuesin e licencuar të dëmeve në sigurime;
 - d. Dokumentacionin për Administratorin(ët) e shoqërisë dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit, sipas pikës (a), (b), (e), (f) dhe (g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - e. Dokumentacionin për aksionarin/ët ose ortakun/ët, sipas pikës (a), (e) dhe (g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - f. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikat dhe/ose procedurat për:
 - i. Mënyrën e trajtimit të dosjes së dëmit;
 - ii. Zbatimin e standardeve, etikës profesionale, paanshmërisë në procesin e vlerësimit të dëmeve në sigurime.
2. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 16

Procedurat e licencimit

1. Autoriteti shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur për licencim. Autoriteti nëse vëren mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, apo nëse e gjykon të nevojshme, njofton kërkuuesin për licencim për plotësimin e tyre brenda një afati 30 ditor. Ky afat mund të zgjatet edhe me 30 ditë të tjera për arsye të justifikuara. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk plotësohet dokumentacioni, shqyrtimi i kërkesës/aplikimit ndërpritet. Në rast riaplikimi, dokumentacioni duhet të depozitohet nga e para.
- 1/1. Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të personit juridik, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.
2. Autoriteti, brenda 2 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuarit për licencë, jep licencën për ushtrim veprimtarie në vlerësimin e dëmeve.
 3. Licenca është me afat të pacaktuar.

Neni 17

Refuzimi i licencës

Autoriteti refuzon kërkesën për pajisje me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të

dëmeve në sigurime, në rastet kur shoqëria nuk përmbush kërkesat e nenit 14 dhe 15 të kësaj rregulloreje.

Neni 18

Rastet dhe procedura e revokimit të licencës

1. Autoriteti revokon licencën e shoqërisë së vlerësimit të dëmeve, në rastet kur:
 - a. Ka shkelur kushtet e licencimit sipas kërkesave të caktuara në ligj dhe në aktet e autoritetit;
 - b. Licenca është marrë mbi bazën e të dhënave jo të vërteta, të rreme, dokumente të falsifikuara;
 - c. Nuk disponon policën e përgjegjësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 229, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - d. Nuk përmbush më kushtet, për të cilat i është dhënë licenca;
 - e. Nuk fillon veprimtarinë e saj brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës;
 - f. Janë hapur procedurat e falimentimit;
 - g. Merret vendimi për përfundimin e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Autoriteti i revokon licencën personit juridik si vlerësues i dëmeve:
 - a. Në rastet e parashikuara në nenin 228, pika 1 të ligjit 52/2014.
 - b. Kur provohet se vazhdon situata e shkeljes së ligjit edhe pas dhënies së gjobës, për:
 - i. Ushtrim të veprimtarisë në kundërshtim me parimet e paanshmërisë të përcaktuara në nenin 233, të Ligjit 52/2014;
 - ii. Ushtrim të veprimtarisë në kundërshtim me standardet dhe etikën profesionale të përcaktuara në nenin 234, të Ligjit 52/2014;
 - iii. Mosrespektim të kufizimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 230, të Ligjit 52/2014.

Neni 19

Rastet dhe procedura e pezullimit të licencës

1. Licenca për të ushtruar veprimtari të vlerësimit të dëmeve në sigurime, pezullohet kur:
 - a. I caktohen me vendim të Autoritetit, masa për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive, afati i pezullimit është maksimumi 6 muaj;
 - b. Vazhdon për më shumë se 30 ditë situata e shkeljes së lehtë, por e përsëritur e Ligjit 52/2014, e ligjeve të tjera të fushës apo akteve të Autoritetit edhe pas dhënies masë administrative - gjobë. Afati i pezullimit është maksimumi 6 muaj;
 - c. Kanë kaluar 10 ditë nga përfundimi i vlefshmërisë së policës së sigurimit të përgjegjësive profesionale, dhe nuk është rinovuar polica. Afati i pezullimit është maksimumi 30 ditë.
2. Procedura e pezullimit të licencës bazohet në kodin e procedurave administrative. Njoftimi i fillimit të procesit të pezullimit të licencës, bëhet me shkrim. Vendimi përfundimtar njoftohet me

shkrim. E drejta për t'u dëgjuar realizohet në takimin e organizuar në Autoritet dhe kur njoftimi i vendimit bëhet me takim, Autoriteti mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer.

3. Në vendimin e pezullimit caktohet shkaku i pezullimit dhe afati i pezullimit të licencës.

Neni 20

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale

1. Personi fizik apo juridik që kërkon të ushtrojë veprimtari vlerësimi dëmsh në sigurime, pas marrjes së licencës nga Autoriteti, por para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, duhet të disponojë sigurimin e përgjegjësisë profesionale sipas parashikimeve të nenit 229, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Sigurimi i përgjegjësisë profesionale, për personin fizik që kërkon të ushtrojë veprimtari vlerësimi dëmsh në sigurime, sipas parashikimeve të nenit 229, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, duhet të disponohet:
 - a. Para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë;
 - b. Ndërsa në rastin e vlerësuesit të pavarur, para regjistrimit në QKB dhe fillimit të ushtrimit të veprimtarisë.
2. Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, e rinovuar, depozitohet në Autoritet çdo vit, brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e përfundimit të vlefshmërisë së saj.

KREU V RAPORTIMI

Neni 21

Fillimi i ushtrimit të veprimtarisë

1. Vlerësuesi i pavarur i dëmeve pas marrjes së licencës nga Autoriteti brenda tridhjetë (30) ditëve regjistrohet në QKB.
2. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime për të vërtetuar fillimin e ushtrimit të veprimtarisë, duhet të depozitojë në Autoritet informacion mbi vlerësimet e kryera, brenda gjashtë (6) muajve nga data e marrjes së licencës.
3. Informacioni i kërkuar depozitohet sipas Formularit A “Të dhëna të përgjithshme mbi vlerësuesin e pavarur të dëmeve në sigurime”, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Neni 21/1
Ruajtja e kërkesave të licencimit

Kërkesat për licencimin e subjekteve të përcaktuara në këtë rregullore duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës që licencat janë të vlefshme. Monitorimi i përmbushjes së kërkesave bëhet nga Autoriteti offsite një herë në vit dhe nëpërmjet inspektimeve në vend kur e gjykon të arsyeshme.

Neni 22
Raportime të tjera

Vlerësuesi i dëmeve raporton në AMF, brenda dhjetë (10) ditëve pune, çdo ndryshim që është objekt regjistrimi në QKB.

KREU VI
SANKSIONET
Neni 23

Sanksionet për vlerësuesit e dëmeve janë ato të parashikuara në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, në nenin 251, për shkelje të neneve 226 dhe 227 dhe në nenin 253 për shkelje të neneve 229, 230, 233 e 234 të Ligjit 52/2014.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24
Dispozitë kalimtare

Vlerësuesit e dëmeve, që nuk kanë filluar aktivitetin dhe aktualisht mbajnë licencën e vlerësuesit, duhet të depozitojnë brenda datës 30 korrik 2017, Formularin A të plotësuar me të dhënat e përgjithshme dhe të dhënat për fillimin e aktivitetit.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

TË DHËNA TË PERGJITHSHME MBI VLERËSUESIN E PAVARUR TË DËMEVE NË SIGURIME

Emri i vlerësuesit të dëmeve: _____

Nr. dhe data e licencimit: _____

NIPT: _____

K ë r k e s a t	
Adresa e plotë	
Telefon dhe fax:	Telefon: _____ Fax: _____
Adresa E-mail:	
Data e regjistrimit në QKR:	
*Të dhëna për policën e sigurimit të përgjegjësive profesionale ndaj palëve të treta <i>(Bashkëngjitur kopje të saj)</i>	Datë fillimi
	Datë mbarimi
	Shoqëria e sigurimit
	Shuma e sigurimit
Aksionarët ose ortakët e shoqërisë së vlerësimit të dëmeve <i>(Plotësohet vetëm nga shoqëria e vlerësuesve të dëmeve)</i>	1
	2
	3
Vlerësuesit e licencuar për llogari të shoqërisë së vlerësimit të dëmeve: <i>(Plotësohet vetëm nga shoqëria e vlerësuesve të dëmeve)</i>	1
	2
	3
**Kopje e aktit të vlerësimit të hartuar nga vlerësuesi	Të dhëna të palëve:
	Data e hartimit të aktit:
	Gjykata e Rrethit Gjyqësor:

**Polica e përgjegjësive profesionale, e rinovuar, depozitohet çdo vit dhe depozitohet në Autoritet brenda 30 ditësh nga data e përfundimit të vlefshmërisë së saj;*

***Kopja e aktit të vlerësimit të hartuar nga vlerësuesi, depozitohet në Autoritet, brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës.*

Data:

Nënshkruesi:

DREJTUAR: AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

**FORMULAR – KËRKESË
PËR
PAJISJE ME LICENCË “VLERËSUES I DËMEVE NË SIGURIME”**

Në mbështetje të Ligjit nr.52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, unë

Z./Znj. _____, paraqes kërkesën për pajisje me licencë

“Vlerësues dëmsh në sigurime”, si person fizik.

1. Të dhënat personale janë si më poshtë:

Emri

Atësia

Mbiemri

Adresa e vendbanimit:

Rrethi, Qyteti, Rruga

Adresa ku do të ushtrohet veprimtaria / selia:

Rrethi, Qyteti, Rruga Kontakt:

Tel /Cel....., Fax E-mail.....

2. Aplikimi për licencë bëhet si:

- Vlerësues i dëmeve materiale motorike;
- Vlerësues i dëmeve materiale të pronës;
- Vlerësues i dëmeve nga sigurimi i përgjegjësive, kreditit dhe garancive;
- Vlerësues i dëmeve të tjera;
- Vlerësues i dëmeve shëndetësore.

3. Veprimtaria e vlerësuesit të dëmeve në sigurime do të ushtrohet në:

A. Klasat e sigurimit të Jo-Jetës:

- Sigurimi i aksidenteve; Sigurimi i shëndetit; Sigurimi i avionëve; Sigurimi i mjeteve tokësore; Sigurimi i anijeve; Sigurimi i mallrave në transport; Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës; Sigurimi nga dëmtime të tjera pasurore; Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve; Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve; Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i anijeve; Sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme; Sigurimi i kreditit; Sigurimi i garancive; Sigurimi i humbjeve financiare; Sigurimi i mbrojtjes ligjore. Sigurimi i asistencës.

B. Klasat e sigurimit të Jetës

- Sigurim Jete; Sigurim martesë, lindje; Sigurimi i Jetës i lidhur me SIK Anuitete; Sigurimi shtesë.

(Shënim: Përzgjedhja e grupeve në të cilën do të ushtrohet veprimtaria, shoqërohet me një përshkrim të argumentuar mbi bazën e eksperiencës apo trajnimeve të kryera, si dhe kërkesës se tregut mbi grupin respektiv).

4. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime do të kryejë veprimtari të tjera dytësore:

Po

Jo

Në rast se Po, cilëso veprimtarinë:

Nëpërmjet plotësimit të formular kërkesës dhe dokumentacionit plotësues bashkëngjitur këtij formulari, deklaroj se informacioni i paraqitur është i plotë, i vërtetë, i saktë dhe nuk përmban fshehje të fakteve.

Trajtimi i të dhënave personale në këtë formë kërkesë dhe dokumentacionit bashkëngjitur do të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Personi Kërkues:

(Emër, Mbiemër, Nënshkrim)

Data _____

Shënim: Kjo formë kërkesë është e pavlefshme, nëse nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga Ligji.

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES I FORMULARIT TË KËRKESËS SË APLIKIMIT PËR LICENCË VLERËSUESI DËMESH NË SIGURIME

Personi fizik që kërkon të pajset me licencë vlerësuesi dëmsh në sigurime duhet të paraqesë:

- a) CV dhe kopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Diplomën universitare;
- c) Dokument (Certifikatë) lëshuar nga një institucion apo organizatë e njohur profesionale që vërteton kryerjen e kualifikimit profesional për vlerësues dëmsh;
- d) Dokument që vërteton përvojën profesionale në vlerësimin e dëmeve;
- e) Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- f) Dokument që vërteton, se nuk ka detyrime të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore, Banka e Shqipërisë, etj.;
- g) Deklaratë se nuk ka qenë i dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes;
- h) Deklaratë se as ai vet, as bashkëshorti/ja dhe fëmijët, përfshirë dhe ato në kujdestari, nuk janë aksionar, agjent, broker apo persona që merren me administrimin dhe auditimin e shoqërisë së sigurimit;
- i) Deklaratë se nuk është i angazhuar në veprimtari tjetër biznesi apo profesion që cenon integritetin, pavarësinë dhe aftësitë e tij profesionale;
- j) Deklaratë se nuk është i punësuar në shoqëri sigurimi (vetëm për vlerësuesin e pavarur);
- k) Deklaratë se do të jetë i paanshëm dhe i pavarur, duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi;
- l) Deklaratë se do të veprojë në përputhje me standardet dhe etikën profesionale dhe do të jetë i kujdesshëm në marrëdhëniet e tij profesionale;
- m) Deklaratë se do të punojë duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit, që do të marrë gjatë ushtrimit të detyrave dhe se nuk do ta përhapë këtë informacion pa marrë paraprakisht miratimin e palëve përkatëse, përveç se kur në legjislacionin në fuqi është parashikuar ndryshe.

Shënim: Sigurimi i përgjegjësisë profesionale, për personin fizik që kërkon të ushtrojë veprimtari vlerësimi dëmsh në sigurime, sipas parashikimeve të nenit 229 të Ligjit nr. 52/2014, dt. 22.05.2014, duhet të disponohet:

- a) Para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë;
- b) Ndërsa në rastin e vlerësuesit të pavarur, para regjistrimit në QKR dhe fillimit të ushtrimit të veprimtarisë.